

VENDIM
Nr. 34, datë 28.2.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 263/3 prot., datë 21.2.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Energy Financing Team Tirana’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 377, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike që nga data 27.7.2017, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, me afat vlefshmërie deri në datën 27.7.2022, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 251 prot., datë 10.2.2022, ka paraqitur kërkesën për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga aplikimi është konstatuar mungesë e theksuar e dokumentacionit, si vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Mungojnë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Plotësuar pjesërisht. Mungon struktura në formë skematike dhe çdo dokument që disponon shoqëria (marrëveshje/kontratë), në lidhje me shërbimin që ofron për këtë veprimtari grupi inxhiniero-teknik i kompanisë mëmë;

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit), plotësuar pjesërisht. Mungojnë pasqyrat financiare të audituara për vitin 2018;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërke;

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti), pa plotësuar. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërke.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike bazuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s. Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 377, seria T17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, data 27.7.2017.

2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e këtij vendimi të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria, për qëllime të rinovimit të licencës, do të konsiderohet i vlefshëm.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti